



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1246/3 prot.

Tiranë më 13.102017

REKOMANDIM

Nr. 42, datë 13.10.2017

MBI

ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

Baza Ligjore: Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, nenet 30, 31 dhe 32 të tij.

Ligji Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

Në zbatim të Urdhrit Nr.229, datë 15.09.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "Aulona Pol I Security" sh.p.k Tiranë, me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit "Aulona Pol I Security" sh.p.k Tiranë.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrin Nr.229, datë 15.09.2017 të Komisionerit.

Kontrolluesi "Aulona Pol I Security" sh.p.k, është subjekt juridik me NIPT: K26307202E, me objekt aktiviteti: "Sigurimi i objekteve publike dhe private në pronësi ose në përdorim të personave fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë. Sigurimin dhe mbrojtjen e jetës dhe shtëndetit të personave fizik, shtetas shqiptar dhe të huaj".

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim u konstatua:

1. Në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese të zyrës së Komisionerit është konstatuar se kontrolluesi nuk ka "Njoftuar" pranë Zyrës së Komisionerit në lidhje me përpunimin e

të dhënave personale, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit. Mbas marrjes dijëni nëpërmjet urdhrorit për kryerjen e hetimit administrativ, kontrolluesi ka depozituar pranë zyrës së Komisionerit "Formularin e Aplikimit" për realizimin e "Njoftimit".

Konstatimi i pikës së parë përbën shkelje administrative të nenit 21 dhe 22 të Ligjit.

2. Kontrolluesi disponon rregullore për mbledhjen e përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale.
3. Kontrolluesi ka nënshkruar "Deklaratë Konfidencialiteti" me punëmarrësit të cilët kanë akses në përpunimin e të dhënave personale.
4. Kontrolluesi mbikëqyr ambientet e brendshme dhe të jashtme nëpërmjet sistemit të video-survejmimit. Në zyrat e administratës së kontrolluesit, ka kamera vëzhgimi, për të cilat është marrë pëlqimi i punonjësve.

Konstatimi i pikës së katërt përbën shkelje administrative të nenit 5 pika 1/b të Ligjit "grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime", nenit 6 "kriteret ligjore për përpunimin" dhe të nenit 27 pika 2/1 "Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masa tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera"

5. Konstatohet se janë vendosur tabela informuese por ato nuk janë sipas modelit standard të miratuar nga Komisionerit nëpërmjet Udhëzimit nr.3 datë 05.03.2010 "Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejmimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" në hyrje të ambienteve në të cilin kontrolluesi ushtron aktivitet.

Konstatimi i pikës së pestë, përbën shkelje administrative të nenit 18 pika 1 të Ligjit "Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektet e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij"

6. Kontrolluesi informon subjektet e të dhënave "punëmarrës" në lidhje me përpunimin e të dhënave nëpërmjet sistemit të gjeolokalizimit (GPS) të vendosura në mjetet motorike të kompanisë dhe me të cilët lëvizin në ushtrim të detyrave të ngarkuar.
7. Kontrolluesi ka hartuar në formë shkresore "Politikat e Privatësisë" por nuk i ka publikuar në portalin zyrtar të <http://www.aulonapol.al>. Portali është në përditësim. Konstatimi i pikës së shtatë, përbën shkelje administrative të nenit 18/1 të Ligjit.

Çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale dhe pavarësisht nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet portalit on-line në internet, ka detyrim të publikojë "Politikat e Privatësisë" pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash, realizohet nëpërmjet portalit zyrtar të kontrolluesit. Publikimi i "Politikave të Privatësisë" përmes qëllimin e nenit 18 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Në përfundim të kontrollit administrativ, duke u bazuar në provat dhe konstatimet, grupi i kontrollit hartoi procesverbalin dhe e lexoi në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit, të cilët u shprehën se: *“Do të organizohemi të përmbushim të gjitha kërkesat dhe konstatimet e grupit të kontrollit”*.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, përpara marrjes së aktit final, kontrolluesi *“Aulona Pol I Security”* sh.p.k është njoftuar zyrtarisht për pjesëmarrjen në seancë dëgjimore në datën 09.10.2017, për të ushtruar të drejtën e tij për tu dëgjuar.

Në seancën dëgjimore, përfaqësuesit e kontrolluesit paraqitën pretendimet e tyre, që konsistojnë në:

- Mbas marrjes dijeni për kryerjen e hetimit administrativ, kemi vënë në dispozicion të institucionit tuaj *“Formularin e Aplikimit”* për realizimin e *“Njoftimit”*.
- Në zyrat e shoqërisë *“Aulona Pol I Security”* sh.p.k është i vendosur sistemi i video-surveimit. Të gjithë punonjësit kanë marrë dijeni që nga momenti i vendosjes së kamerave dhe për këtë kanë dhënë pëlqim me shkrim. Duhet të sqarojmë se bazuar në objektin e veprimtarisë së shoqërisë tonë dhe bazuar në Ligjin *“Për shërbimin privat të sigurisë fizike”* sistemi i video-surveimit ka qënë i nevojshëm.
- Për sa i përket konstatimit të shkeljes së *“Politika e Privatësisë”* nuk është e publikuar në portalin zyrtar të shoqërisë *“Aulona Pol I Security”* sh.p.k, sqarojmë se faqja web është duke u punuar për rikonfigurimin e saj.

Sa më sipër:

Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të neneve 5 dh 6 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, kontrolluesi *“Aulona Pol I Security”* sh.p.k:
 - të ndalojë mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave nëpërmjet sistemit të video-surveimit në zyrat e administratës.
 - të heqë kamerat e pranishme në zyrat e administratës
 - të shkatërrojë të gjitha të dhënat personale (imazhet video) të cilat ndodhen në sistemin e video surveimit (CCTV), të regjistruara nga kamerat e vendosura në zyrat e administratës.

2. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi "Aulona Pol-1 Security" sh.p.k. Tiranë, të publikojë në portalin zyrtar të tij, rubrikën "Politikat e Privatësisë".
3. Kontrolluesi "Aulona Pol 1 Security" sh.p.k Tiranë, të realizojë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda afatit 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 13/10/2017

KOMISIONERI

Besnik Dervishi